

NJOFTIM
Nr. 2374, datë 25.5.2023

**PËR KANDIDIM PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË
KËSHILLIT TË STATISTIKAVE, PËRFAQËSUES TË MEDIAS**

Në mbështetje të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, dhe të pikës 2, të vendimit nr. 670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e për zgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, shpallim njoftimin për kandidim për anëtar të Këshillit të Statistikave.

Konkurrimi është i hapur për përfaqësuesin që i përket **medias**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtar të Këshillit të Statistikave, përfaqësues të medias, janë, si më poshtë vijon:

Kandidati për anëtar, përfaqësues i medias:

- i. të jetë nga radhët e medias kombëtare;
- ii. të jetë i punësuar me kohë të plotë;
- iii. të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e gazetarisë ekonomike.

Kritere të përgjithshme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të jetë person i padënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

Shënim. Kandidatët për anëtar në Këshillin e Statistikave duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin që provon plotësimin e kriterëve, sipas këtij njoftimi.

Afati i dorëzimit të aplikimit është deri më 16.6.2023, dhe të dorëzohet në adresën e Kryeministrit. Kandidatët e kualifikuar do të njoftohen nëpërmjet *e-mail-it*.

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1000

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: 04 22 77 401